

AKTIVITETE SHKENCORE

PROJEKTI KËRKIMOR “ATLASI ETNOGRAFIK I FSHATIT SHQIPTAR SOT” PËRGJATË VITIT 2022

Projekti “Atlas Etnografik i Fshatit Shqiptar Sot” (AEFSS) ka vijuar programin e vet përgjatë vitit 2022, viti përmbyllës i tij. Projekti u konceptua dhe u zbatua në kuadër të zhvillimit të shkencave sociale dhe albanologjike, me synimin për t’ju përgjigjur sfidave që paraqet shoqëria bashkëkohore shqiptare. AEFSS u ndërtua si një platformë kërkimore për të dokumentuar dhe kuptuar dimensionin social, kulturor, politik, ekonomik dhe historik të disa prej fshatrave që ishin pjesë e programit të zhvillimit të 100 fshatrave të qeverisë shqiptare. Bazuar në dijet antropologjike të ofruara nga një staf i nivelit të lartë akademik, gërshtuar me trashëgiminë e pasur që Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit (IAKSA) zotëron në studimin e fshatit e kulturës tradicionale në përgjithësi, AEFSS u konceptua si një projekt kërkimor që ka natyrë sa shkencore, aq edhe aplikative. Natyra aplikative e këtij projekti lidhet drejtpërdrejt me kontributin që shkencat sociale dhe albanologjike mund të japin në zhvillimin e turizmit kulturor në fshatin shqiptar. Ndërsa të dhënat empirike dhe analizat antropologjike që diktohen prej tyre hapnin shtigje të reja në dijen albanologjike. Qëllimi madhor i AEFSS është ngritja e një platforme kërkimore në fushën e antropologjisë së shoqërisë bashkëkohore, e cila ndërthur problematikat teorike me të dhëna etnografike dhe folklorike të cilat sa na flasin për të djeshmen dhe të tashmen e fshatit shqiptar, po aq na tregojnë antropologjikisht edhe për kushtin e rures mesdhetare, ballkanike dhe evropiane në modernitet dhe bashkëkohësi.

Projekti ishte parashikuar që të aplikohet në një hark kohor prej 2 vitesh duke nisur nga muaji Tetor 2019, por si pasojë e pandemisë së covid-19 stafi u detyrua disa herë që të bëjë ndryshime të axhendës së punës në terren gjë që u pasua nga një shtyrje e zbatimit të projektit për një

vit me miratimin e entit mbështetës AKKSHI. Projekti u realizua në harkun kohor prej 30 muajsh duke e shtrirë punën kërkimore në 57 fshatra nga 30 të parashikuar në projekt. Arsyeja sepse numri i fshatrave e tejkalon propozimin lidhet me aplikimin në punën kërkimore të të ashtuquajturit ‘thellim zonal’ dhe ‘rrjetëzime zonale’ ku janë zhvilluar gjurmime dhe dokumentime etnografike në fshtatrat pjesë e të njëjtit program në disa Bashki. Kjo qasje na ka dhënë mundësinë e zgjerimit të hartës së fshatrave në të cilat u realizua kërkimi përpos grupit të fshatrave të parashikuar në projekt. Në këtë projekt u angazhuan 10 studiues dhe 2 anëtarë të stafit ndihmës shkencor nga departamenti i Etnologjisë dhe Folklorit të IAKSA-së. Metodologjia e AEFESS është shumë shtresore. Puna kërkimore në lidhje me këtë projekt kërkimor ka ndërthurur qasjen prezentiste me atë historiciste; diakroninë me sinkroninë. Kërkimi në terren kombinonte holizmin me partikularizmin. Në dokumentimin etnografik të fshatit u aplikuan parimet klasike të punës etnografike: vëzhgime, përshkrime, qendrim në komunitet, pyetje gjysëm të struktura e bashkëbisedime me njerëz të zakonshëm dhe intervista të thëlluara me informantë kyçë. Mbledhja e të dhënave empirike është bërë duke përdorur pyetëtorin e njësuar. Intervistat e strukturuar dhe gjysëm të strukturara janë zhvilluar në të gjitha ekspeditat, me anëtarë të komuniteteve të fshatrave dhe me aktorë kyçë si drejtues të komuniteteve religjioze, kryepleqtë e fshatrave, ish-drejtues të kooperative bujqësore, specialistë, mësues, ish-brigadierë, artizanë, pensionistë, mbartës të dijes lokale dhe të rinjtë. Intervistat variojnë nga 30 minuta deri në 3 orë. Me lejen e të intervistuarëve një pjesë e mirë e intervistave janë dokumentuar nëpërmjet rregjistrimeve audio dhe video. Po ashtu, materialiteti arkitekturor, peizazhi dhe dukuri të caktuara janë dokumentuar me anë të fotografive. Peshë specifike kanë marrë vendet që mbartin një domethënie të veçantë për komunitet lokale. Janë rregjistruar po ashtu histori gojore dhe ngjarje që kanë shënuar në kohë jetët e njerëzve dhe komuniteteve rurale. Raporti mes tradicionales dhe modernes në përvijimin e kulturës në fshat ka qenë pjesë e rëndësishme e dokumentimit etno-folklorik gjatë ekspeditave kërkimore. Përpos pyetëtorit të njësuar që ka qenë baza mbi të cilën është mbledhur e dhëna etnografike dhe folklorike studiuesit janë ndalur edhe në tema që lidhen me interesin e tyre të ngushtë kërkimor apo me fushën e tyre të specializimit.

Temat kryesorë të kërkimit kanë qenë *institucionet dhe morfologjia sociale, familja dhe shtëpia, jeta ekonomike, jeta e “shenjtë”, jetë rituale dhe rite-kalime, jeta politike dhe drejtësia, dijjet lokale, kultura materiale, arti popullor, në të djeshmen dhe të tashmen.*

Në terma sasiorë janë zhvilluar 938 ditë ekspedita në terren nga 960 të parashikuara për këtë projekt. Lënda empirike e mbledhur në këtë projekt përveç shënimeve në bllokun e etnografit dhe folkloristit përbehet në tërësi nga mbi 6000 fotografi, 80 000 minuta intervista, 5000 minuta xhirime HDDI dhe 5000 minuta intervista të plota. Vetëm ky material zë një volum prej më shumë se 6 TB. Produktet e kërkimit janë të shumëllojshme.

Pasurimi i arkivit etnografik me të dhëna të reja mbi kushtin e fshatit shqiptar është ndër kontributet kryesore që vjen nga ky projekt. Me digjitalizmin e plotë të materialit sipas gjineve të evidentuara në skedën e përgatitur me këtë qëllim, ekzistojnë të gjitha mundësitë e krijimit të një platforme të aksesueshme për publikun e interesuar. Paralelisht, ciklet e botimeve që janë duke u përgatitur do të mundësojnë akses më të madh në informacionin dhe analizat përkatëse përsa i përket komuniteteve rurale. Këto botime me karakter aplikativ do të përfshihen në një kolanë të veçantë botimesh të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit e cila do të mbajë siglën e *Antropologjisë së Aplikuar*. Këto botime do të jenë të konsultueshme lehtësisht online në faqen e www.iaksa.edu.al. Një tjetër gjini botimesh që projektohen të dalin duke u bazuar në lëndën empirike të mbledhur nga ky projekt janë *monografitë tematike* me fokus mbi një çështje të caktuar të Atlasit Etnografik. Gjithashtu lënda vizuale e mbledhur është duke u përpunuar për të realizuar dokumentar të shkurtër etnografik në funksion të popullarizimit të Atlasit Etnografik. Bazuar në çfarë është vërejtur ndër mekanizmat kryesorë për turistifikimin e fshatrave sugjerimi dhe kontributi i drejtpërdrejtë do të ishte në ngritjen e *muzeve etnografik*. Muzeu nuk do të ishte vetëm ‘vitrina’ e kulturës tradicionale por duke e ftuar komunitetin në pjesëmarrje aktive në propozimin atëherë *muzeu etnografik* do të kthehej në qendër të jetës komunitare. Aktualisht, projekti AEFSS, është bërë pika e fortë e lidhjeve me kolegët e departamentit etnologjik të Institutit Albanologjik të Prishtinës, pasi ai është marrë si model në ndërtimin e Atlasit Etnografik të Fshatit Kosovar,

projekt që po financohet nga Ministria e Kulturës në Kosovë. Për më tepër, projekti i ka dhënë shtysë, projekt-propozimit të Atlasit Urban që pritet të miratohet nga Akademia e Studimeve Albanologjike, si një hulli kërkimore 9 vjecare për Institutin e Antropologjisë Kulturore.

Përgatiti Ervin Kaçiu

PROJEKTI 7- VJEÇAR NDËRKOMBËTAR “A SMALL BUT FERTILE FIELD: STRENGTHENING SOUTHEAST EUROPEAN STUDIES”

Nisi zyrtarisht, me datë 05.10.2022, projekti 7-vjeçar ndërkombëtar “A small but fertile field: Strengthening Southeast European Studies” me qendër në Universitetin e Regensburgut-Gjermani. Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit (IAKSA) është ndër partnerët kryesor të projektit, pasi ndër qëllimet parësore të tij është hapja e fushës së Studimeve Shqiptare në Universitetin e Regensburgut. Projekti ka bërë bashkë një rrjet të gjerë institucionesh akademike të Europës Perëndimore dhe Ballkanit me qëllimin e forcimit të dijeve humane në institucionet e arsimit të lartë. Në këtë kuadër janë parashikuar mbështetja dhe forcimi i mësimdhënies dhe kërkimit shkencor mes institucioneve partnere në këtë projekt. Nismat konkrete të projektit do të njoftohen vazhdimisht në faqen zyrtare të IAKSA dhe ASA. Ky projekt mbështetet nga institucioni prestigjioz gjerman VolkswagenStiftung.

Për më shumë info: <https://seefield.app.uni-regensburg.de/about/>

Përgatiti Olsi Lelaj

TRAGË – CIKËL LIGJËRATASH RRETH FOLKLORIT, TRADITËS, ARTEVE DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

Cikli i ligjëratave *Tragë* i organizuar nga departamenti i folklorit është rikthyer sërish pas ndërprerjes thujse dy-vjeçare pandemike, ndërprerje e justifikuar nga dëshira për të mbajtur aktiv komunikimin njerëzor të drejtpërdrejtë dhe jo atë të zhvilluar në mënyrë virtuale, pavarësisht praktikitetit që sjell. Për vitin 2022, kishim të ftuar ligjërues nga Shqipëria, Kosova dhe Europa.

Ligjërata e parë u mbajt nga Morten Traavik (Norvegji) dhe titullohej “Repeat after me’ - Nënshtrimi dhe çlirimi në muzikën pop”. Artist shumëplanësh që punon me një spektër të gjerë zhanresh artistike, i njohur gjerësisht për punët e tij me shoqëritë totalitare, Morten Traavik foli rreth muzikës pop si një mjet sugjestionues për publikun dhe masat. Si pikë fillestare në ligjëratën e tij për Tragë, ishte përvoja krejt unike me organizimin e koncertit të parë dhe deri tani të vetëm rock në Korenë e Veriut nga grupi rock *Laibach*. Kurse e dyta ishte realizimi i albumit *Take on us*, në të cilin 5 instrumentistë koreanë interpretojnë hite të muzikës pop perëndimore. Përmes këtyre veprave, ndër të tjera të vlerësuara nga publiku dhe kritika ndërkombëtare, Traavik diskutoi rreth rëndësisë që ka për të rileximi në një lente personale i gjuhëve dhe mjeteve shprehëse ekzistuese të kulturës populare, si pjesë e një reformësimi dhe artikulimi të brendshëm. Krahas kësaj, ai e zgjeroi diskutimin edhe me realitete të tjera, duke trajtuar edhe mediumet që ai zgjedh për t’u shprehur, ndër të cilat një vend të posaçëm zënë filmi dhe videoklip. Ligjërata e Tragës u përgatit nga Mikaela Minga dhe Donika Çina dhe u realizua si bashkëpunim mes Departamentit të folklorit - IAKSA, me Departamentet e KMDP-së dhe atë të Multimedias të Universitetit të Arteve.

Për **ligjëratën e dytë** kishim të ftuar prof. dr. Arbnora Dushin, drejtuese e Departamentit të Folklorit në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Dushi prezantoi aspekte të lidhura me folklorin si kujtesë dhe praktikë, të cilat ajo i ka trajtuar gjerësisht dhe imtësisht në librin e saj të

fundit (*Folklori si kujtesë dhe praktikë*, Prishtinë, 2021). Ky libër është rezultat i punës disa vjeçare të autores ku trajtohen lidhja e të rrëfyerit dhe të kujtuarit me folklorin; kujtesa ndërbreznore ndaj çështjes së kufirit; historia gojore e autoetnografia; balada në këngën popullore si kujtesë; folklori i pandemisë e tema të tjera që lidhen me rrethanat aktuale të krijimit të folklorit në vazhdimësi. Studiuesja Dushi e ndërton tezën e saj mbi idenë e lëvizjes së paradigmës shkencore për folklorin, gjegjësisht zgjerimit të kufijve të definicionit të tij, bazuar në shembujt teorikë nga praktikatat e folkloristikave ndërkombëtare. Paradigma e folkloristikës kombëtare, krahas tendencave të reja akademike e nevojave që i imponon praktika e terrenit, për ta ridefinuar folkloristikën është në fokusin e studimit të saj. Ligjërata u mbajt në sallën Rrok Zojzi të IAKSA-së më 5 prill 2022.

Në vijim, në dt. 6 maj, po në ambientet e IAKSA-së kishim sërish të ftuar nga Prishtina, Rilind Gërvallën, për **ligjëratën e tretë** me titull "Lejohet - S'lejohet". Aktualisht, Rilind Gërvalla është gazetar dhe redaktor përgjegjës i lajmeve ndërkombëtare në Radio Televizionin e Kosovës. Ai shfaqti për publikun dokumentarin televiziv "Lejohet – S'lejohet" i punuar në vitin 2007 brenda formatit të Radio -Televizionit të Kosovës (RTK). Aty flitet për një momenti specifik (fillimi i viteve 2000 e në vijim), kur disa pjesëmarrës të skenës rock së para luftës, për shkak të bindjeve fetare, braktisën muzikën. Kjo kishte ndikimin e vet kur kemi parasysh që kjo skenë vuri themelet e saj kryesisht në fillimvitet '70-të (e ndikuar nga trendi i skenës rock jugosllave me elemente të rock-ut britanik dhe amerikan) dhe që gjatë viteve 90-të, kur Kosovës iu hoq autonomia dhe, si rrjedhojë, u ndaluan të gjitha grumbullimet publike, aktivitetet kulturore si koncertet, kaluan në ilegalitet duke u kthyer në një formë të rëndësishme të rezistencës kulturore. Këto grupe gjetën metodën e depërtimit në masë, duke ndërthurur në muzikën e tyre, elemente të vargut dhe melodisë folklorike, po ashtu duke e konvertuar shpeshherë muzikën me elemente epike në zhanrin rock. Në fund të viteve '90-të, ky aktivitet u organizua në formë fushate për thirrjen e institucioneve ndërkombëtare për ndërhyrje në Kosovë. Pas ndërhyrjes ushtarake të NATO-s, paslufta filloi me shfaqjen e një konflikti kolektiv identitar, fetar dhe kulturor. Në këtë kuadër, shumë aktivitete, përfshirë edhe ato të lidhura me muzikën rock u bënë të debatueshme. Dokumentari paraqet këtë lloj situatë dhe ballafaqon dy

karaktere të cilat kanë mendime të kundërta për muzikën, performancën dhe instrumentet muzikore. Autori i dokumentarit, Rilind Gërvalla, pas shfaqjes diskutoi rreth realizimit të tij por edhe mënyrës si u prit vetë ky dokumentar nga publiku.

Ligjërata e katërt u mbajt nga Fatos Dibra, filolog, hulumtues në fushën e turkologjisë dhe albanologjisë, kryesisht mbi turqishten ballkanike, shumëgjuhësinë në kontekstin shqiptar si dhe tekstet e vjetra shqipe. Në këtë prezantim të titulluar “Një lexues për Divanin e Sulejman Naibit” bëri një paraqitje të disa rezultateve të punës me tekstin e Divanit të Sulejman Naibit (sh. 18-të). Vetë rigjetja e këtij teksti dhe sjellja e tij para studiuesve, sidomos atyre të interesuar në fushat e gjuhësisë, letërsisë, filologjisë, antropologjisë, etj., përben një ngjarje me rëndësi. Tekste të tilla si Divani i Sulejman Naibit janë, në fakt, ‘klasikë’ të letërsisë shqipe – sigurisht, jo vetëm për shkak të moshës së teksteve dhe të kohës që kanë qenë në qarkullim si pjesë e “konsumit” letrar, duke trajtuar përmbledhtas disa çështje që lidhen me poezinë dhe tekstin e Divanit të Sulejman Naibit si: kodi poetik, sufizmi, gruaja, ninullat, gjuha.

SEMINARI PERMANENT PËRTHYERJE ANTROPOLOGJIKE

Seminari Permanent *Përthyerje Antropologjike* gjatë vitit 2022 ka sjellë disa prezantime librash. Siç është edhe shpallur tanimë, synimi kryesor i këtij aktiviteti është krijimi i një mjedisi ku mundësohen përthyerje pikëpamjesh antropologjike mbi kulturën dhe shoqërinë. I konceptuar si një aktivitet i përhershëm i Departamentit të Etnologjisë, në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit (ASA), ky seminar e lëvront këtë synim përmes një serie takimesh të rregullta, ku prezantohen monografi, studime, projekte kërkimore, si dhe filma antropologjikë. Zhanret e shqyrtimit apo dokumentimit të jetës së përditshme janë objekt i prezantimit dhe debatit të hapur. Këtë vit, përgjatë seminarit patëm rastin e prezantimit të tre librave studimore me fokus arkitekturën, ndërtimin, urbanen, modernitetin dhe

antropologjinë. Në vijim, po paraqesim përmbledhje të shkurtra rreth fjalëve të secilit prej ligjëruesve të ftuar.

Natasa Gregoric Bon, Smoki Musaraj: *Prezantimi i librit Remitting, Restoring, and rebuilding contemporary Albania (Springer Books, 2021)*

07 korrik 2022

Vëllimi *Remitting, Restoring, and rebuilding contemporary Albania* përbën një kontribut të ri në studimet antropologjike, sociologjike, dhe gjeografike të hapësirës dhe kohës në Europën Juglindore dhe veçanërisht mbi Shqipërinë. Kapitujt analizojnë hapësira dhe praktika të ndryshme të jetës së përditshme si, letërsinë, marrëdhënien me ambientin, procesin e urbanizimit, artin, fotografinë, traumën e kujtesën dhe procesin e modernizimit përgjatë periudhës së komunizmit dhe në tridhjetë vitet mbas përfundimit të luftës së ftohtë në Shqipëri. Kapitujt janë shkruar nga studiues të Shqipërisë, vendas, nga diaspora dhe të huaj, të cilët punojnë në institucione akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ofruar perspektiva dhe qasje të reja në dijen antropologjike dhe më gjerë.

Agron Mesi: *Prezantimi i librit Projektimi ideologjik i modernizimit urban të Shqipërisë. (Akademia e Studimeve Albanologjike, 2022)*

30 shtator 2022

Libri ka për objekt studimi modernizimin urban të Shqipërisë. Ky modernizim, si një proces i shtrirë historikisht në kohë e hapësirë përgjatë një shekulli të tërë, atij të XX, në tërësinë e tij do të njohë dy përthyerje politike ekstreme, dy projektme zhvillimi me inspirime ideologjike dhe njëkohësisht dy orientime kulturore të ndryshme. Fillimisht, gjatë gjysmës së parë të këtij shekulli, me shkëputjen përfundimtare të Shqipërisë nga pushtimi osman më 1912, kemi hapjen ndaj modernitetit perëndimor, i cili do të mundësohet falë reformave oksidentalizuese zogiste dhe veçanërisht

nëpërmjet protektoratit neokolonial italian. Me praninë e Italisë fashiste, territori urban i Shqipërisë do të shndërrohet në një laborator eksperimental të prezantimit të pushtetit politik nëpërmjet aspekteve përshfaqëse të urbanizimit dhe arkitekturës, të përdorura si paradigma të modernitetit, të europianizimit të vendit, por njëkohësisht duke e alienuar këtë prej kohës aktuale dhe hapësirës së vet organike të trashëguar prej shekujsh.

Në vijim, me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore më 1945, merr fund dhe prezenca perëndimore e më pas për vendin e shoqërinë shqiptare fillon një epokë krejtësisht e re historike, pa asnjë lidhje me të kaluarën, ajo e sistemit komunisto-socialist lindor. Vëmendje të veçantë studimore në tekst marrin disa dukuri urbane pikërisht të kësaj periudhe, që kanë të bëjnë me modernizimin socialist të Shqipërisë, i konceptuar dhe trajtuar në vazhden e tij 45-vjeçare si një projekt politik me kumte të mirëfillta ideologjike. Pjesë e kësaj natyre projektimi bëhen disa dukuri e zhvillime urbane, siç janë: centralizimi (nga ana e shtetit) i të gjitha koncepteve, politikave, projekteve e ndërmarrjeve konkrete për planifikimin urban të territorit e zhvillimin demografik të popullsisë, roli komandues (po i shtetit) në trajtimin e trashëgimisë urbane të së kaluarës, në rimodelimin socialist të saj, në themelimin e qendrave të reja të banimit, në hartimin e politikave për strehim, në përdorimin e hapësirës publike për qëllime propagandistike, etj. Filli lidhës i këtyre dukurive urbane do të jetë *moderniteti* si vizion dhe *modernizimi* si mision, si dhe përpjekjet për të mundësuar materializim e tyre mbi territorin dhe shoqërinë shqiptare me ndërmjetësinë e *ideologjisë komuniste* dhe të sistemit politik të *socializmit shtetëror*.

Arba Baxhaku: *Prezantimi i librit Identitete Pluskuese: Një lexim mbi shfaqurimin e peizazhit arkitektonik të Tiranës pas rënies së Socializmit (Berk 2021).*

28 tetor 2022

Libri “Identitete pluskuese/Floating Identities-Një lexim mbi shfaqurimin e peizazhit arkitektonik të Tiranës pas rënies së Socializmit” i

autores Arba Baxhaku synon të gjurmojë një lidhje midis arkitekturës së traditës shqiptare dhe natyrës informale të transformimeve spontane të Tiranës bashkëkohore. Përpjekja për të vendosur një lidhje midis tipareve të kundërta të formalizmit funksionalist, tipike për qytetin që u rrit gjatë regjimeve totalitare, dhe atyre të arkitekturës informale, që përfaqësojnë lirinë konstruktive të kohëve të fundit, synon të japë një interpretim kritik të zbatueshëm për ndërhyrjet e fundit për rikuperimin e trashëgimisë arkitekturore ekzistuese.

Arba Baxhaku është arkitekthe dhe studiuese. Punët e saj përkufizohen nga një bisedë e vazhdueshme midis kërkimit teorik dhe praktikës së projektimit: RI-SHKRIMI ose si të interpretohet arkitektura ekzistuese si një dialog midis së kaluarës dhe modernitetit. Ato kanë të përbashkët qasjen e rindërtimit të fragmenteve të botës formale që lidhen ngushtë me kontekstin: një vazhdimësi faktesh, historish dhe përvojash arkitektonike që shërbejnë si principe themelore të objektit të ndërtuar. Arba është pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë e Tiranës, ku është përgjegjëse për projektet e artit publik, projekte arkitekturore që lidhen me kulturën dhe trashëgiminë historike të qytetit. Në këtë cilësi, ndër të tjera, ajo është përfshirë në projektet e muzealizimit të Shtëpive Studio Kadare dhe Agolli, udhëhequr nga Elisabetta Terragni: hapësira kushtuar kujtesës dhe studimit të veprës së shkrimtarëve Ismail Kadare dhe Dritero Agolli. Aktualisht, ajo është pjesë e stafit me kohë të pjesshme të Fakultetit të Arkitekturës së Universitetit Politeknik të Tiranës.

KONFERENCA SHKENCORE VJETORE E IAKSA-SË
ATLASI ETNOGRAFIK SHQIPTAR: KULTURA, NATYRA, ARTI
Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit,

22-23 nëntor 2022

Konferenca Shkencore “Atlasi Etnografik Shqiptar: Kultura, Natyra, Arti” kishte disa akse kryesore prezantimi që lidhen me rezultatet e punës

kërkimore dyvjeçare të kërkuesve të IAKSA-së. Konferenca u hap me paraqitjen e rezultateve paraprake të projektit kërkimor “Atlasi Etnografik i Fshatit Shqiptar Sot”, mbështetur financiarisht nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Qëllimi kryesor i këtij projekti ka qenë dokumentimi i shndërtimeve të mëdha që ka sjellë moderniteti mbi fshatin shqiptar. Lënda empirike e gjeneruar në mbi 40 fshatra të Shqipërisë tregon përmasat e ndryshimeve në jetën kulturore, politike, ekonomike dhe sociale të komuniteteve rurale nga formimi i shtetit shqiptar deri në bashkëkohësi. Disa nga nëntemat ishin: Koncepti dhe praktika e atlasit etnografik; Areali kulturor, zona kulturore, fusha sociale, kufiri; Fshati në vëzhgimin antropologjik. Në vijim, Departamenti i Arteve paraqiti projektin kërkimor me fokus Arkivin e Artit Bashkëkohor. Përveç punëve të kërkuesve pranë IAKSA-s, në këtë konferencë paraqitën projektet kërkimore që janë zhvilluar ose po zhvillohen në Departamentin e Etnologjisë-Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Departamenti i Antropologjisë - Universiteti i Prishtinës. Projekti “Atlasi Etnografik i Kosovës” i Departamentit të Etnologjisë - Instituti Albanologjik i Prishtinës sapo ka nisur dhe frymëzohet dhe mbështetet mbi modelin e “Atlasit Etnografik të Fshatit Shqiptar Sot”. Ai është produkt i marrëveshjeve bilaterale mes Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe Institutit Albanologjik të Prishtinës. Kurse projekti “Kujtesa e Kosovës” i Departamentit të Antropologjisë - Universiteti i Prishtinës ka frymëzuar aspekte të punës kërkimore në “Atlasin Etnografik të Fshatit Shqiptar Sot”. Këtyre projekteve iu bashkohen studime mbi bujqësinë, natyrën, mjedisin e tema të tjera.

Të marra së bashku, këto projekte që paraqiten në konferencën shkencore “Atlasi Etnografik Shqiptar: Kultura, Natyra, Arti”, synojnë të shpalosin zhvillimet dhe bashkëpunimet në Antropologjinë Shqiptare. Në këtë aspekt koncepti i Atlasit Etnografik ka zgjeruar veprimtarinë e kërkimit etnografik në Shqipëri drejt horizonteve të reja, e specifikisht në hapjen për leximin sistematik të realitetit urban. Për këtë panel janë ftuar kolegë dhe aktivistë për të prezantuar projektet, idetë dhe nismat e tyre që lidhen me jetën urbane. Së fundi, në këtë konferencë u prezantua edhe “Atlasi Urban” projekti më i ri kërkimor i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit.

Duke marrë shkas nga këto punë kërkimore në ecuri e sipër, është menduar që konferenca shkencore të jetë një lloj platforme që mundëson paraqitjen e rezultateve të kërkimit dhe tezave, të cilat analizojnë ndryshimet e thella në raportin e njeriut me natyrën, transformimet social-kulturore, aftësitë artkrijuese dhe artit si pjesë e jetës së përditshme. Studimet dhe projektet kërkimore që do të paraqiten në këtë konferencë nuk do të kufizohen historikisht, por do të inkurajohet prurja e studimeve me perspektivë *long dure* ndërthurur me qasje prezentiste. Në terma konkretë, konferenca me këtë titull do të jetë për një periudhë 4 - vjeçare, në të cilën do të shqyrtohen tema të lidhur me natyrën, kulturën, artin kombinuar me projektet dhe akset kërkimore të IAKSA-së, si dhe projektet kërkimore shkencore në fushën e antropologjisë dhe fushave të tjera që lidhen me këto shqetësime teorike dhe praktika shpeshherë ekzistenciale. Do t'i jepet prioritet qasjeve dhe prurjeve mbi Shqipërinë, rajoneve historike si Ballkani e Mesdheu dhe “rajonet” politike si “Europa Lindore”, me qëllim rritjen e kapacitetit krahasues por njëherazi dhe përdorimin e krahasimit si metodë që na shpjen të njohja më të thella dhe më të plota.

EKSPOZITA “XHUBLETA”

Kuruar nga Afërdita Onuzi

Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit,

22 nëntor 2022

Ekspozita etnografike “Xhubleta”, kuruar nga prof.dr Afërdita Onuzi u organizua në ambientet e IAKSA-së, si një tregues i përmasave dhe rolit të madh që ka arkivi i kulturës materiale i këtij Instituti në krijimin e lidhjeve mes traditës dhe modernitetit. Qëllimi i kësaj ekspozite, e cila i parapriu hapjes së punimeve të konferencës shkencore vjetore “Atlasi Etnografik Shqiptar: Kultura, Natyra, Arti” ishte edhe lidhja me optikën e “Atlasit Etnografik. Kjo pasi “Xhubleta” (botim i Departamentit të Etnologjisë, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit –

ASA) është pjesë e një serie botimesh që do të pasqyrojnë kulturën materiale, në kuadër të zbatimit të projektiti “Atlasi etnografik”.

Për xhubletën, sikurse thekson autorja, ka një mori kontributesh nga autorë shqiptarë dhe të huaj, autoritete në fushën e historisë së kulturës dhe antropologjisë. Por asnjëherë më parë nuk kemi patur një vëllim kushtuar xhubletës. Botimi në fjalë është një studim dhe paraqitje e detajuar në shqip dhe anglisht e historisë së prejardhjes, përhapjes, shkaqeve të ruajtjes dhe transmetimit, besimeve dhe domethënieve kulturore. Veç jetës historike të xhubletës, një vend specifik zë trajtimi i saj në ciklin e jetës së njeriut: kur vishet për herë të parë “xhubleta e mirë”, “xhubleta e keqe”, pra xhubleta për nusëri, e xhubleta për jetën tjetër etj.

Vetë ekspozita ishte edhe një formë prezantimi shumë dimensionale e vëllimit *Xhubleta* nga Afërdita Onuzi. Ajo e prezanton veshjen e xhubletës dhe të varianteve të saj si përfaqësuese të periudhave të ndryshme të jetës, por edhe se si ndryshon modeli i saj nga Dukagjini, Nikaj Mërturi, në Kelmend, prej gjysmës së dytë të shek. XIX deri në fillim të shek. XX. Pjesë e veshjes janë stolitë që përpunoheshin nga artizanët e Shkodrës dhe Prizrenit. Xhubleta ka tërhequr rregullisht vëmendjen e etnografëve shqiptarë e të huaj dhe akoma më herët të udhëtarëve që kanë eksploruar botën shqiptare nga perspektiva antropologjike. Edhe në ekspozitë veshja u shfaq në arealin e saj etnografik, në mesin e karrigeve, stolave, ndriçuesve, enëve që i përkasin fundit të shek.XIX, ndërsa autorja dhe kuratorja Onuzi ndau përvojën e saj shumëvjeçare të njohjes dhe studimit të xhubletës që zë fill në vitin 1972.

Për rastësi, ekspozita dhe prezantimi i paraprinë regjistrimit të dihebërjes së xhubletës në Listën e Trashëgimisë Kulturore të UNESCO-s, një ngjarje shumë e rëndësishme për ruajtjen dhe njohjen e kësaj veshjeje.

EKSPOZITA “TINGUJ TË HESHTUR
INSTRUMENTE MUZIKORE TË TIRANËS SIPAS ARKIVIT
ETNOGRAFIK (IAKSA)

Kuruar nga Mikaela Minga dhe Vilma Nallbani,
në bashkëpunim me Ermal Selën.

Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit,

7 dhjetor 2022

Instrumentet muzikore që janë përdorur në Shqipëri, kryesisht në kuadrin e praktikave tradicionale përbëjnë një koleksion të pasur në arkivin etnografik të Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit (IAKSA). Nxitur nga kjo, Departamenti i Folklorit ka menduar organizimin e një cikli ekspozitash prezantuese të këtij koleksioni nën titullin "Tinguj të heshtur". Arsyeja pse e kemi quajtur kështu ka të bëjë me faktin që instrumentat e këtij koleksioni kanë “heshtur” në çastin që janë marrë dhe janë futur në arkiv. Megjithatë, edhe kështu ato kanë çfarë të rrëfejnë. Si fillim, u mor si pikë referimi Tirana, me ekspozitën dedikuar hapësirës qytetare e rurale, realizuar në 7 dhjetor 2022 në ambientet e IAKSA-së. Megjithatë, kjo nuk ka kuptim përjashtues ndaj vendeve të tjera rrethepëranë. Instrumentet muzikore nuk njohin kufij të ngushtë gjeografikë. Të gjithë këto eksponate që janë këtu, kanë një hartë përdorimi edhe në zona të tjera të Shqipërisë; janë përdorur e disa ende përdoren. Nga studimet e bëra instrumentariumi shtrihet në një hartë përdorimi që shkon nga Afrika e Veriut, në Lindjen e Mesme dhe vjen drejt Mesdheut e Ballkanit, sigurisht duke kaluar procese “aklimatizmi” siç i quajnë Ramadan Sokoli dhe Pirro Miso.

Në këtë event u ekspozuan vegla muzikore të 4 kategorive: aerofone, membranofone, vegla idiofone dhe ato kordofone. Përmes tyre vërehen fazat e ndryshme në të cilat ka kaluar muzikëbërja: nga format më parake instrumentale si pjesë e botëve rituale e rurale; te repertoret më të konsoliduara brenda ansambleve të muzikës urbane dhe argëtimit. Vend zënë gjithashtu edhe instrumente që janë përdorur brenda praktikave

fetare, siç janë ato të bektashinjve dhe helvetive. Ajo që është e rëndësishme që të nënvizojmë ka të bëjë me faktin se ndërsa disa instrumente vazhdojnë ende të bëjnë një jetë aktive, disa të tjera kanë dalë nga përdorimi. Kësisoj, njohja, ruajtja dhe kujdesi ndaj këtyre instrumenteve bëhen thelbësore për të gjurmuar nga afër procesin, sikurse mund të ofrojë edhe një mundësi për rikthimin e tyre si pjesë e proceseve të mundshme të rivitalizimit të praktikës.

Aspirata është ajo e pasjes së një hapësire të vazhdueshme ekspozimi për instrumentet muzikore, ndaj shpresojmë që kjo ekspozitë të shërbejë edhe si formë sensibilizimi.

Përgatiti Mikaela Minga

ZÂDHANIA E JETËVE TË PAREGJISTRUARA TË BATHORES SHTËPIA – ARDHJA – VARRI LABORATORI I ANTROPOLOGJISË URBANE

Kamëz, Bathore, Tetor – Nëntor 2022

Edhe këtë vit, përgjatë datave 29 tetor - 1 nëntor u mbajt punishtja “Zâdhania e jetëve të paregjistruara të Bathores” si vazhdimësi e tematikës së vjetshme “Shtëpia, Ardhja, Varri”, pjesë e Labororit të Antropologjisë Urbane. Ky Laborator u organizua si bashkëpunim mes Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit në Tiranë dhe grupit të aktivistëve të Kamzës “Ata”. Në LAU 2022 morën pjesë rreth 21 pjesëmarrës, studentë, aktivistë dhe studiues të fushave të ndryshme si: art, arkeologji, arkitekturë, shkenca politike, letërsi etj. Në pjesën e parë të punishtes u prezantuan materiale filmike të fermës “Ylli i Kuq”, të arkivuara në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, të cilat synonin të rindërtonin historinë urbane të zonës së përzgjedhur për studim; u bashkëndanë ide dhe mënyra të qasjes etnografike në terren; si dhe

pritshmëritë dhe projekt-idetë e pjesëmarrëse. Në fazën e dytë u organizua puna për terren, ku fillimisht u prezantua zona ku do të realizohej kërkimi etnografik.

Zona e kërkimit në terren këtë vit ishte lagjia nr. 6 e Bathores, ose siç njihet ndryshe mes banorëve të Kamzës “stallat”. Zgjedhja e kësaj zone është bërë me qëllim për të sfiduar dhe testuar kapacitetin e qasjes etnografike si dhe dimensionin etik të punës në një prej lagjeve më të stereotipizuara dhe, njëherazi, ndoshta të parin vendbanim të vetëthemeluar pa lejen e shtetit, përgjatë periudhës post-socialiste. Me gjasë, dhe zanafillën e urbanizimit të gjithë zonës përreth. Për t’u realizuar më mirë intervistat në familjet pritëse, pjesëmarrësit u ndanë në tre grupe, dhe arritën të intervistonin afro 12 familje të Bathores. Secili pjesëmarrës, varësisht grupit në të cilin bënte pjesë, qëmtonte një temë të caktuar, duke ndjekur trinomin e punishtes, përkatësisht shtëpinë, ardhjen ose varrin.

Në ditët që po realizohej puna në terren u mbajtën dy leksione. “Përpjekje arkitektonike të panjohura” ishte i pari leksion i mbajtur nga studiuesja Dorina Pllumi. Ajo prezantoi punën kërkimore të tezës së saj doktrale në zonën e ish-Kombinatit. Qasja e Pllumit, u shndërrua në një udhëzues për lexime dhe interpretime të tjera mbi lagjen e Ish-Stallave të Lopëve në fermën Ylli i Kuq. Leksioni i dytë u mbajt nga studiuesi Ervin Kaçiu, i cili bashkëndau me pjesëmarrësit vështrimin e tij teorik mbi varfërinë urbane, specifikisht të komunitetit rom dhe egjiptian. Ky leksion u mbajt në një shtëpi të papërfunduar në Bathore.

Në fund të fazës së dytë, u realizua një vizitë studimore në Institutin e Antropologjisë Kulturore, ku pjesëmarrësit e punishtes u njohën me arkivat e këtij institucioni si dhe me rezultatet paraprake të projektit “Atlasi Etnografik Shqiptar”, prezantuar nga studiuesi Olsi Lelaj. Në përmbyllje të këtij aktiviteti 4-ditor u diskutuan filizat e tematikave ku secili pjesëmarrës do të punonte për prezantimin final.

Faza e tretë e punishtes konsistoi në një periudhë përgatitore gjatë së cilës disa prej studiuesve plotësuan punën kërkimore në terren, realizuan lexime teorike apo hulumtuan burime arkivore nga disiplina të ndryshme. Të gjithë këto dolën në pah gjatë ditës së prezantimeve që u mbajt më datë 12 nëntor. Për shkak të shumësisë disiplinare të pjesëmarrësve, prezantimet preknin mënyra të ndryshme leximi të urbanes: nga dokumentimi grafik e

fotografik të funksionit parësor të stallave, në transformimin e tyre në hapësira banimi, në regjstrim të rrëfimeve mbi pluralitetet e ikjes dhe emigrimit të banorëve të zonës, e përbashkëta në kushtet e pamjaftueshmërisë individuale, përkatësia e gruas në faza tranzitore të zhvendosjes, gjetje të kulturës materiale të ardhjes dhe ndryshimit të vendbanimit, deri në përshkrime dhe sinopse imazhi lëvizës gjatë intervistimeve. Këto prekje dhe të tjera prezantime, të cilat nuk mund të përmenden të gjitha këtu, dëshmuar për bulëzimin e disa narrativave të reja mbi jetën në zonën e ish-stallave të Bathores.

Përgatiti Diana Malaj dhe Nebi Bardhoshi

